

» NJOFTIM

Marrja e krediteve për drejtuesit e praktikës profesionale

Të nderuar drejtues praktikash,

Ju informojmë se për të përfituar **10 kreditet e vlefshme** pas përfundimit të periudhës 3-mujore të drejtimit të praktikantëve, është e domosdoshme që të **ngarkoni në portalin e-Albania**




dokumentacionin përkatës **deri më datë 3 dhjetor 2025**.

Dokumentet që duhet të ngarkohen janë:


- 1) **Vërtetimi i drejtuesit të praktikës**, i cili gjenerohet automatikisht në **platformën e UISH** (në seksionin “Gjenero vërtetimin e drejtuesit”)
- 2) **Vërtetimi i lëshuar nga shefi i shërbimit**, që konfirmon se ju keni udhëhequr praktikantin gjatë periudhës së praktikës profesionale.

Hapat që duhet të ndiqen për vërtetimi i drejtuesit të praktikës:

- a) Hyni në **platformën e UISH**: <https://app-uish.org>
- b) Nga menuja anësore, zgjidhni:
Zona e Administrimit → Praktikë → Praktikë e Përfunduar



- c) Gjeni emrin e praktikantit dhe klikoni:
Veprimet → Shiko



Kliko **Gjenero vërtetim ndjekjeje** .

Aty do ju shfaqet vertetimi i leshuar nga ne.

✦ **Ju kujtojmë se këto vërtetime shërbejnë si dëshmi zyrtare e rolit tuaj në drejtimin e praktikës dhe janë kusht i domosdoshëm për përfitimin e krediteve.**

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe për angazhimin tuaj në zhvillimin profesional të praktikantëve.

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë